UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike P r i sh t i n ë

Në bazë të vendimit nr. 336 të datës 02/03/2021, të Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë është formuar komisioni në përbërje:

UNIVERSITETI I PRISHTINES "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
PRISHTINE

Pranuar me: 06.09.2021			
Nj. org.	Numër	Shtojca	Vlera
08	1134	—	—

1. Prof.Dr. Mirlind Bruqi, , *kryetar*
2. Prof. Dr,. Agron Pajaziti, *mentor*
3. Prof.Ass.Dr. Xhevahir bajrami, *anëtar*

Për vlerësimin e punimit Master me titull: "Programimi i scara robot dhe shiritit transportues me dpl (plc) me softuerin simantic menager" ("programming robot scara and conveyer with plc using semantic manager software), të kandidatit bachelor Fatbardh krasniqi.

Pas kontrollimit të punimit të lartëpërmendur Komisioni jep këtë:

R A P O R T

Punimi Master me titull "programimi i scara robot dhe shiritit transportues me dpl (plc) me softuerin simantic menager" – ("programming robot scara and conveyer with plc using semantic manager software), është hartuar në 7 (Shtatë) kapituj kryesor dhe është ilustruar me figura, grafe dhe tabela të nevojshme.

Në përmbledhje/abstrakt kandidati ka mbuluar çdo hap me sqarime, diagrame, figura dhe rezultate praktike. Në përfundim ka arritur ta realizojë një metodë alternative të kontrollimit të scara robotit dhe shiritit transmetues .

Punimi është ndarë në shtatë kapituj kryesorë:

Në kapitullin e parë janë paraqitur definicioni i PLC-ve përparsitë e saj, bazë të një sistemi komandues, njesit hyrëse, njesia dalëse, arkitektura e PLC-së, programet e PLC-së.

Në kapitullin e dytë kandidati fillimisht ka paraqitur informatat e përgjithshme Simatik S7-300 pastaj ka filluar me klasifikimin e tyre, përparësitë, mangësitë dhe përdorimet S7-300 . Pas kësaj ka paraqitur parimin e punës duke u thelluar në detajet e konstruktimit të S7-300 të cilat përdoren këto module, modulet e memories të CPU-së S7-300, Njësia qendrore e përpunimit, modulin e sinjaleve SM, moduli i komunikimit CP, ku ka paraqitur figura të qarta të cilat përshkruajnë llojet dhe tipet e moduleve hap pas hapi. Pas kësaj ka paraqitur karakteristikat e SIMATIC S7-300 pozicionimin e moduleve të S7-300 në raft si dhe funksionimin e S7-300.

Në kapitullin e tretë fillimisht ka përshkruar mënyrat e komunikimt të plc-ve të simatic s7-300, llojet e lidhjeve te komunikimt të moduleve në mesë veti dhe lidhjen e simatic S7-300 dhe modulet e tij me PC dhe scara robotin .

Në kapitullin e katërt ka përshkruar pjesët mekanike të shiritit transportues dhe robotit scara. Ka paraqitur Modelin e scara roboti dhe shiritin transmetues, kinematien e scara robotit, ka paraqitur pjesët përbërëse të aksit të parë, aksit të dytë dhe tret dhe komandat e lëvizjes, si dhe butonat për startimin e scara roboti, senzorat, kontaktoret rregullatort për rregullimin e shpejtësis motorat e akseve, pistonat pneumatik.

Në kapitullin e pestë. Ka paraqitur urdhërat të cilat përdoren për programimin e scara robotit dhe shiritit transmeturs. Ka pershkruar operacionet logjike binare, operacionet logjike krahasuesit e vlerave, shprehjet matematikore, kohmatësat (timer) transformimin e vlerave, këto urdhëra përdoren për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në proqesin automatizimt .

Në kapitullin e gjashtë ka paraqitur Programin SIMATIC menager S7 ku përdoret për krijimin e programeve të cilat programohen me kontrollin logjik PLC.Gjatë programimit kemi perdorur gjuhet programuese LAD FBD dhe STL, janë treguar startimi i simatic menager s7 , procesi i konfigurimit të CPU S7-300 si dhe modulet e saj,ka paraqitur blloqet e programit të cilat mundësojn dhjeshtimin gjatë proqesit të programimit të scara robotit.

Në kapitullin e shtatë janë elaboruar metodat e ndryshme logjike gjatë programimit të skara robotit . Janë treguar teknikat e ndryshme të rregullimit varësisht nga modi i punës, janë përdorur gjuhët e programuese LAD FBD STL të cilat programohen ne programin simatic menager S7, Të gjitha teknikat e rregullimit janë ilustruar me diagramet rregulluese përkatëse.

PËRFUNDIM

Në bazë të të dhënave të përshkruara më lartë, Komisioni për Vlerësimin e punimit Master konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i pasqyruar me figura, diagrame dhe tabela të nevojshme. Prandaj, komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, që punimin Master, me titull:

"PROGRAMIMI I SCARA ROBOT DHE SHIRITIT TRANSPORTUES ME DPL (PLC) ME SOFTUERIN SIMANTIC MENAGER"" – (PROGRAMMING ROBOT SCARA AND CONVEYER WITH PLC USING SEMANTIC MANAGER SOFTWARE), të kandidatit *Bachelor* Fatbardh Krasniqi, ta aprovojë si punim për Master, dhe ta jepë në diskutim publik.

Komisioni:

1. Prof.Dr. Mirlind Bruqi, Kryetar: M. Bruqi
2. Prof. Dr,. Agron Pajaziti, Mentor: _____
3. Prof.Ass.Dr. Xhevahir Bajrami, Anëtar: _____

Prishtinë, Shtator 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

DEPARTAMENTI: PRODHIMTARI DHE AUTOMATIZIM

LËNDA: Sistemet jolineare të rregullimit automatik

PUNIM DIPLOME
MASTER

TEMA:

“Programimi i scara robot dhe shiritit transportues me DPL (PLC) me softuerin Simantic Menager”

Mentor : Prof.dr.Agron Pajaziti

Kandidati:BSc. Fatbardh krasniqi

Prishtinë, 2021

Përmbajtja

Hyrje 6

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT 7

1.1 Definicioni i PLC-ve: 7

1.2. PLC përparsitë e saj: 7

1.3 Zbatime PLC 7

1.4 Pjesët bazë të një sistemi komandues 8

1.5 Sinjalet hyrëse 8

1.6 Sinjalet dalese 9

1.7 Programet PLC-s 9

1.8 Arkitektura e PLC-ve 9

1.9 Komanduesi logjikë i programueshëm (PLC) 10

2. PARATHËNJE PËR PROGRAMIN SIMATK S7 -300 10

2.1 SIMATIK S7 -300 10

2.2 Përdorimi i simatik S7-300 10

2.3 Përdorimi special 10

2.4 Kostot e ulta inxhinierike 11

2.5 Kostoja e ulët e operimit 11

2.6 Modulet e PLC S7-300 për komandimin të robotit SCARA 11

2.7 Moduli i furnizimit me energji elektrike (Power supply (PS)) 12

2.8 Moduli i Memories të CPU-së S7-300 12

2.8.1 Njësia qendrore e përpunimit (CPU) 12

2.9 Moduli I sinjaleve SM 13

2.1.1 Moduli i komunikimit CP 343-1 Lean 13

2.1.2 Karakteristikat e SIMATIC S7-300 14

2.1.3 Pozicionimi i modulit S7-300 në raft 15

2.1.4 CPU S7 – 300 dhe funksionimi i tij 16

3 MËNYRAT E KOMUNIKIMT TË PLC-VE SIMATIC S7-300 17

3.1 lidhja e rrjetit të SIMATIC-ut dhe lidhjet e pjeseve të PLC-së 17

3.2 Pika e shumëfishtë e ndërfaqjes – MPI 18

3.3 Profibus 18

3.4 Profinet 19

3.5 Ethernet Industrial 20

4. ELEMENTET PËRBËRËSE TË SHIRITIT TRANSPORTUES DHE ROBOTIT SKARA 21

4.1 Shiriti transmetues dhe roboti scara 21

4.2 Modelimi i robotit SCARA 22

4.3 Kinematika inverze e SCARA Robotit 23

4.4 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit të parë dhe me komandat e lëvizjes 24

4.5 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit dytë 24

4.6 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit të tretë 25

4.7 Shiriti transmetues 26

4.8 Shiritit transportues me elementet përbërëse 26

4.1.1 Komandimi i robotit SCARA dhe shiritit 27

4.1.2 Tipet e komandimit 27

4.1.3.Komandimi i realizuar përmes lidhjeve mekanike të fiksuara: 28

4.1.4.Komandimi i realizuar përmes lidhjeve mekanike të ndashme: 28

4.1.5 Tipet e sinjaleve në teknikën e kontrollimit 28

4.1.6. Sijalet binare 28

4.1.7 Vlerat binare 29

4.1.8 Sinjalet analoge 29

5. SIMBOLET DHE VARIABLAT PËR PROGRAMIMIN E PLC-së 30

5.1 URDHËRAT E PËRDORURA PËR PROGRAMIMIN E SCARA ROBOTIT DHE SHIRITIT TRANSMETURS 30

5.2 Udhëzimet e përdorura 30

5.3 Simbolet e operacioneve binare 32

5.1.2 Kontakti NO (---| |---) 32

5.1.3 Kontakti NC ---| / |--- 32
5.1.4 Operacioni logjik binar DHE OSE (AND dhe OR) 33
5.1.5 Operacioni logjik binar NAND dhe NOR 34
5.1.6 Operacione logjike binare: (XOR) 34
5.3 Operacionit Logjik 35
5.3.1 Operacionit Logjik Starto dhe Ristarto Prodhimin (Set, Reset) 35
5.3.2 Ristarto_Starto Flip Flop (rivendos_vendos) dhe RS Reset_set Flip Flop 36
5.3.4 Vija e mesme dalëse (#) (Midline Output) 36
5.3.5 Operacionit Logjik NOT 37
5.3.6 Detektimi kufitar i RLO-së, Pozitiv (P) dhe Negativ (N) 38
5.3.7 Krahasimi i dy vlerave 38
5.3.8 Funksionet bazike matematikore 39
5.3.9 Lëvizja (Move): Transferimi i vlerave 40
5.3.1 kohëmatësit ‘’ Timer ’’ 40
5.3.7 kërcimi i kushtëzuar JUMP-së 41
6 PROGRAMI SIMATIC MENAGER STEP 7 42
6.1 Startimi i SIMATIC Manager 44
6.2 Konfigurimi i CPU-së 44
6.3 Tabela e konfigurimit të një rafti 50
6.1.1 Blloqet e programit simatik menager S7 50
6.1.2 Blloqet të cilat përdoren për programin e scara robotit dhe shiritit transmetues 50
6.1.3 Blloku Organizativ OB 50
6.1.4 Bllokut organizativ OB1 51
6.1.5 Startimi i bllokut organizativ OB100 51
6.1.6 Blloku Funksional (FC) dhe Blloku Funksional (FB) 51
6.1.7 Funksioni (FC) 52
6.1.8 Blloku Funksional (FB) 52
6.1.9 Sistemi i blloqeve funksionale SFB dhe Funksioni sistemit (SFC) 53

6.2.1 funksioni i sistemit (SFC) 53

6.2.2 Sistemi i blloqeve funksionale SFB 53

6.2.3 DB Bllok i të dhënave 53

6.2.4 Krijimi themelor i një blloku DB 54

6.2.5 Kontrollimi i numëruesve me SFB47 “COUNT” 54

SFB 43 "PULSEGEN" (gjenerator impulsi) 54

6.2.6 Adresimet e përdorur në PLC 54

6.2.7 Llojet elementare me të dhëna në STEP7 54

6.2.8 Blloku për lidhjen e SIMATIC S7-300 dhe komjuter PC 55

6.2.8.1 Karakteristikat e blloqeve të komunikimit FC5 "AG_SEND" dhe FC6 "AG_RECV" 55

7. PROGRAMIMI PËR KOMANDIMIN E ROBOTIT SKARA PËRMES HARDVERIT PLC S7-300 DHE PROGRAMIT SIMATIC MENAGER S7 55

7.1 OB1 Programi organizativ Kryesor I fuksionit të robotit scara 56

7.2 Qarku I programit kryesor CIKLI 56

7.3 FC8 Nën Funksioni i programit Për pozicionin fillestar startimi I scara robotit 60

7.4 FC10 Nën Funksioni i programit Për komandimin e akseve manuale dhe automatike 63

7.5 FC11 Nën Funksioni I programit Për pozicionimin e akseve 67

7.5 DB10 Blloku i të dhënave programuese të lëvizjeve 95

7.6 DB30 DB31 DB32 blloku I te dhenave te sistemit funksional te bllokut SFB47 95

7.7 Tabela e simboleve me të dhënat e përgjithshme programuese të robotit SKARA me S7-300 si dhe komentimi i simboleve. 96

7.8 VAT_1 Tabela e variablave të programimit 99

PËRFUNDIMI 100

LITERATURA E SHQYRTUAR 101

Hyrje

Roboti SCARA është tip i robotit industrial. Shkurtesa “SCARA” nënkupton “ Selective Compliance Assembly Robot Arm”. Tek ky robot, nyjet janë të lëvizshme përgjatë aksit X dhe Y por përgjatë aksit Z ato janë të palëvizshme. Kjo paraqet një avantazh të përdorimit të ktij tipi të robotit për arsye se gjatë proceseve të montimit p.sh vendosja e shufrës në vrimë rrethore arrihet pa përkuljen e nyjeve të robotit me q’rast rritet saktësia dhe stabiliteti i tërësisë.

Veqori tjetër e robotit SCARA është mënyra e lidhjes së nyjeve që i përngjason krahëve të njeriut. Kjo veqori lejon shtrirjen e krahëve të robotit në zona të kufizuara dhe më pas mundëson tërheqen apo palosjen e krahëve përgjatë rrugës.

Robotët SCARA janë dukshëm më të shpejtë se robotët që kanë për bazë sistemin Kartezian. Vend i nevojshëm për shtrëngim të ktyre robotëve është mjaft i vogël me q’rast e bën këtë robot mjaft të dobishëm në zvoglimin e hapsirës së nevojshme e cila do të shfrytëzohet nga ky robot.

Në laboratorin e Mekatronikës është i instaluar Roboti SKARA i cili është i lidhur me shiritin transportues. Me anë të shiritit transportues detektohen produktet e prodhuara me ngjyrë dhe peshë të caktuar, këto produkte të detektuara kapen nga roboti SKARA dhe dërgohen në deponinë e caktuar për paketim.

Me këtë punim të masterit do të tentohet të bëhet programimi me pjesen softwerike STEP7 dhe hardwerike PLC SIMATIK S7-300 për robotin SKARA i cili do të mundëson punën e saktë, shpejtë dhe precize të këtij roboti.

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.1 Definicioni i PLC-ve:

(PLC) është një sistem i bazuar në mikroprocesor që përdoren memorie e programueshme për të ruajtur udhëzimet dhe të zbatojë funksionet të tilla logjike, renditja, koha, numërimi dhe aritmetiken, në mënyrë që të kontrollohen makineritë dhe proceset e llojeve të ndryshme, përmes sinjaleve digjitale apo analoge hyrëse apo dalëse. PLC-të dhe pjesët periferike të tyre janë konstruktuar në mënyrë të tillë që shumë lehtë është i mundur integrimi i tyre në sistemet komanduese industrial.



Fig 1.1 Definicioni i PLC-së

1.2. PLC përparsitë e saj:

Mundësojnë programim të lire Nderrimi i programit pa intervenim në sistem(nuk ka lidhje interne me tela) Është me kompakte, me e lire dhe me e sigurtë se sa sistemet e komandimit me rele lejon mirëmbajtjen më të lire dhe me të thjeshtë(me pak shpenzime pë mirëmbajtje)

1.3 Zbatime PLC

PLC-të kanë një larmi aplikimesh dhe përdorimesh, përfshirë:

Impiantet e Automatizimit të Procesit (p.sh. minierat, nafta dhe gazi)
Industria e qelqit
Industria e letrës
Prodhimi i çimentosNë kaldaja
Termocentralet etj.

1.4 Pjesët bazë të një sistemi komandues

Pjesa më e rëndësishme e një sistemi komandues është PLC-ja dhe programi i sajë . PLC-ja perbehet prej kater pjesve

-pjesa hyrse
-pjesa dales
-pjesa e brendëshme
-CPU



Fig 1.2 baza e një sistemi komandues

1.5 Sinjalet hyrëse

Sinjalet hyrëse arrijnë tek PLC-ja përmes senzorëve. Këto sinjale përmbajnë informata për statusin e sistemit të komanduar. Është e mundur të futen sinjale binare, digjitale dhe surrogate (të ngjashme). PLC-ja mund të njoh dhe të dërgoj vetëm sinjale elektrike. Për këtë arsye, përmes senzorëve sinjalet jo-elektronike shndërrohen në sinjale elektrike. Pjesa e hyrjes i ka senzoret te lidhur si butona shtypës Çelsa etj .

Senzorët (zbuluesit).

Këto pajisje janë të vendosura që të komandojnë drejtpërdrejtë në sisteme ose në makinë, nëpërmes së cilës PLC-ja është e aftë të ndikoi ose të ndryshoi gjendjen edhe si proces teknikë.

Ne procesin e komandimit të robotit SCARA kemi perdorur nje sensor induktiv:

Senzori induktiv- përbëhet nga qarqet me oshilime të frekuencave të larta.

Oshilatori krijon fushë elektromagnetike alternative induktive në sipërfaqen detektuese të senzorit.

Ky senzor përdoret për identifikimin e materialeve metalike, në këtë rast kur materiali metalik kalon ka sipërfaqja detektuese e senzorit, ajo do merr energji e krijuar nga oshilatori, kështu do përcjellet një sinjal elektrik nga senzori për materialin përkatës.

1.6 Sinjalet dalese

Sinjalet dalëse ndikojnë në komandimin e sistemit. Sinjalet mund të dalin në formë binare, digjitale apo surrogate. Sinjalet dalëse amplifikohen në sinjal ndërprerës përmes nxitësve ose shndërrohen në sinjale të një forme tjetër. Nxitës për shembull janë: Llambat, sirenat, zilet, kontaktuesit, pistonat me valvula solenoide, motorë me hap etj.

1.7 Programet PLC-s

Programet PLC-s përbëhen nga një sekuencë logjike e instruksioneve. Programi i kontrollit është i ruajtur në një memorie speciale elektronike të lexueshme, i ashtuquajturi programi i memories të PLC-së. RAM-ët special me bateri rezervë përdoren gjatë zhvillimit të programit, pasi që përmbajtjet e tij mund të ndryshohen prapë shumë shpejt. Pas funksionit të përfundimit ’’ (commissioned)” dhe pa – pengesa ’’(errur) ” të komanduesit, është ide e mirë që (unerasably) të transferohet nga PLC-ja në një memorie vetëm të lexueshme (Reas-only) apo EPROM. Nëse programi ekzekutohet, do të procedohet ne cikle të vazhdueshme. Pjesa e brendshme konsiston si softwera dhe ka pjeset e tilla si relet e kontrollit CR kohuesit TON ose TOF , numeruesit CTU ose CTD , etj

1.8 Arkitektura e PLC-ve

Ka qindra modele të PLC-së në treg të prodhara nga një numër ndërmarrjesh të ndryshme. Në përgjithësi, në një PLC mund të dallojmë pjesët e mëposhtme:

• CPU Central Processing Unit-Njësia Qendrore e Përpunimit.

• Njësia e furnizimit me energji elektrike.

• Njësitë I / O (Input / Output Hyrje / Dalje) CPU-ja, njësia e furnizimit me energji elektrike dhe njësitë I / O përbëjnë njësin kryesore të automatizimit, pra pjesa kryesore e PLC. Në shumë modele, veçanërisht në modelet e vogla të kompanive, tre njësitë e mësipërme janë integruar në një pajisje. Përveç njësisë qendrore të automatizimit, një PLC është akoma e domosdoshme:

•Bazamenti fiksues (RACK) për vendosjen e njësive dhe shtimet e mundshme të tyre.

•Paisja e programimit (programmer) për programimin e PLC.Pajisja programuese është një pajisje plotësisht e ndarë nga njësia e automatizmit. Përdoret për zhvillimin dhe ngarkimin e programit në PLC si dhe monitorimin e funksionimit të automatizmit përmes ekranit, që ai ka. Me një programues të vetëm mund të trajtojmë të gjitha njësitë e PLC-ve të një instalimi të automatizuar. Në shumë raste sot pajisja programuese është zëvendësuar me një kompjuter në të cilin është instaluar programi i nevojshëm.

1.9 Komanduesi logjikë i programueshëm (PLC)

Nga kjo, ne kuptojmë modulet elektrike nëpërmjet të cilit është i kontrolluar funksionimi i gjithë sistemit apo makinave, që janë drejtuar dhe aktivizuar në një rend logjikë.

Ne detyren tone per komandim te robotit SCARA kemi perdorur PLC S7-300.

2. PARATHËNJE PËR SIMATK S7 -300

2.1 SIMATIK S7 -300

SIMATIC S7-300, eshtë një PLC modulare me fleksibilitet të madh dhe performancë të lartë.Lejon zgjedhjen e moduleve të ndryshme dixhitale dhe analoge I / O dhe funksioneve specifike të aplikacionit, Mund të përshtatet në mënyrë optimale për të gjitha detyrat e automatizimit.

Përdorë një memorie të programueshme që mban mend instruksione komanduese për kryerjen e operacioneve si operacionet logjike, funksionet aritmetike, kohore, numerike dhe kontrollon lloje të ndryshme të makinerive ose procesit të prodhimit përmes hyrjeve dhe daljeve digjitale dhe analoge.

Kontrolleri SIMATIC S7-300 ka deri në 6 counters (numeratorë) me shpejtësi të lartë. Tre nga inputet janë 100 kHz dhe tre inpute tjera janë 30 kHz për numërim dhe matje.

Kontrollori SIMATIC S7-300 integron dy dalje pulsi me shpejtësi të lartë prej 100 kHz për lëvizjen e krahut robotik ose kontrollimin e shpejtësisë dhe pozitës së servomotorëve për levizjen e konvejerit.

2.2 Përdorimi i simatik S7-300

SIMATIC S7-300 :më së shumti përdoret për zgjethjen e problemeve të ndryshme dhe në automatizimin e proceseve industrial.
Inxhinierinë e prodhimit
Industrinë automobilistike
Konstruksionet e makinave speciale
Konstruktimin e makinave serike (të gjitha llojet e makinave prodhuese)
Përpunimin e plastikës
Industrinë e paketimit
Industrinë e ushqimit dhe të duhanit
Procesin inxhinierik (p.sh; furnizimi me ujë, inxhinierinë e ndertimit.)

2.3 Përdorimi special

Për përdorime speciale kemi produkte të veçanta të dizajnuara me ndihmën e S7-300 si në vijim:

Aplikimi i ruajtjes nga dështimi me aplikacionin e ri S7-300F sikurse I/0 tani janë të mundëshme

për aplikacionet e kërkuara teknologjike dhe funksionin e kontrollit të lëvizjeve, mund të përdoret teknologjia speciale CPU,

Në të jejtën kohë njesitë e kompletuara SIMATIC S7 janë të lejuara në S7-300 CPU me integrimin e HMI-së për konfigurimin dhe kontrollin makinerik ku hapësira është e kufizuar,

Ky spektër është një qark i ndalur nga CPU në formën e konfigurimit ET 200S e cila bënë shpërndarjen ku procesi intelegjent është i mundur.

2.4 Kostot e ulta inxhinierike

S7-300 karakterizohet nga efiqienca e konfigurimit dhe programimit, e cila rezulton me kosto të ulët inxhinierike. Kualiteti i tërësishëm i strukturave të CPU-së e bën S7-300 një platformë ideale për problemet e caktuara në STEP 7, që është një mjet inxhinierik në përputhshmëri me standardin IEC 61131-3, për shembull në nivele të gjuhëve të larta programuese.

Përveç kësaj, teknologjia orientohet nga kohëzgjatja e softverit. Mjetet inxhinierike gjithashtu janë lehtësuar me programimin modular dhe riparimin e softverit ekzistues. Veglat inxhinierike nuk mbështesin vetëm zhvillimin por gjithashtu edhe riparimin, lehtësimin e mirëmbajtjes dhe dokumentimin e programit. Konfigurimi i procesit të diagnostifikimit për analizimin e dështimeve të mundshme, reduktimin e humbjeve kohore dhe rritjen e produktivitetit janë implementuar në koston inxhinierike.

2.5 Kostoja e ulët e operimit

Mikro kartela e memorjes (the Micro Card MMC) mund të kryejë funksionin si vend ruajtje e të dhënave dhe programit, prandaj nuk është e nevojshme të ketë bateri reserve, dhe gjithashtu kostoja e mirëmbajtjes është më e ulët. MMC mund gjithashtu të ruajë një projekt, duke përfshirë këtu simbolet dhe komentet të cilat bëjnë më të lehtë përdorimin pasi që nuk ka të dhëna të nevojshme në mjetet përkatëse.

MMC lehtësisht, freskon të dhënat. Kjo lejon leximin dhe shkrimin e hyrjes edhe pergjatë ekzekutimit sikurse në shembuj, arkivimin e vlerave të matjeve ose përpunimin e mjeteve që bëhet më i lehtë.

2.6 Modulet e PLC-së S7-300 për komandimin të robotit SCARA

Fig. 2.1 Moduli i PLC-së S7-300 për komandimin të robotit SCARA dhe shiritit transportues

2.7 Moduli i furnizimit me energji elektrike (Power supply (PS))

Ky modul përdoret për të siguruar energjinë e kërkuar për të gjithë sistemin e PLC. Ai shndërron energjinë e disponueshme AC në energji DC e cila kërkohet nga CPU dhe moduli I / O. PLC zakonisht punon në një furnizim 24V DC. Pak PLC përdor një furnizim të izoluar të energjisë.

Njësia e furnizimit me energji elektrike (PS) Njësia e furnizimit me energji konverton furnizimin me rrjetin AC 120/230 V në 24 V DC pë furnizimin e moduleve S7-300.

Fig 2.2. Moduli I furnizimit me energji elektrike (PS)

2.8 Moduli i Memories të CPU-së S7-300

2.8.1 Njësia qendrore e përpunimit (CPU)

Njësia qendrore e përpunimit është për ekzekutimin e programeve të përdoruesve. Komunikon me module të tjera përmes ndërfaqes MPI.

Moduli i CPU-së ka një procesor qendror, memorie ROM & RAM. Kujtesa ROM përfshin një sistem operativ, drejtues dhe programe aplikimi. Memoria RAM përdoret për të ruajtur programet dhe të dhënat. CPU është truri i PLC me një mikroprocesor oktal

CPU lexon të dhënat hyrëse nga sensorët, i përpunon ato dhe më në fund dërgon komandën te pajisjet kontrolluese. Burimi i energjisë DC, siç u përmend në diskutimin e mëparshëm, kërkohen sinjale të tensionit. CPU gjithashtu përmban pjesë të tjera elektrike për të lidhur kabllot e përdorura nga njësitë e tjera. CPU fillon të lexojë të dhënat nga moduli i hyrjes dhe kontrollon statusin e të gjitha hyrjeve.CPU fillon ekzekutimin e përdoruesit ose programit të aplikimit të shkruar në logjikën e shkallës rele ose ndonjë gjuhë tjetër të programimit PLC.Tjetra, e CPU kryen të gjitha detyrat e brendshme dhe komunikimits sipas rezultateve të programit, ajo shkruan të dhënat në modulin e daljes në mënyrë që të gjitha rezultatet të kryhen .

Fig 2.3.Moduli i memories të CPU-së S7-300

2.9 Moduli I sinjaleve SM

modulet e sinjalit SM - gjithmonë zgjidhja e duhur për çdo punë. Sensorët mundësojnë kontrolluesin të përcaktojë statusin aktual të procesit. Modulet dixhitalë dhe analoge sigurojnë hyrjet dhe daljet që u nevojiten aktuatorëve të ndryshëm për të kryer detyrat e tyre.

Moduli i hyrjes dhe i daljes sistemi fut sinjale nga kodifikuesi përmes modulit të hyrjes në S7- 300 ose i nxjerr ato në modulin e daljes. Një ekran LED tregon gjendjen e sinjalit në modulet.

Modulet sinjalizuese (SM)
Hyrja digjitale - modulet: (DE/DI) 24V = 220/230V~
Daljet digjitale – modulet: (DA/DO) 24V = , Reletë,
Hyrjet analoge – modulet: (AE/AO) Tension. Rrymë. Rezistenca Termike,
Daljet analoge – modulet: (AA/AO) Tension. Rrymë.

Fig2.4. Moduli i sinjaleve SM

2.1.1 Moduli i komunikimit CP 343-1 Lean

Moduli i komunikimit CP 343-1 Lean –shërben për lidhjen e PLC-së SIMATIC S7-300 dhe kompjuterit PC me ndihmen e rrjetit LAN, përmes TCP / IP RFC1006, Fetch / Writ, S7 komunikimit (server), pajisje PROFINET I/O të integruar 2- ndërprerës, porti ERTEC 200, Zëvendëson modulit PG, diagnostifikim SNMP, inicializimi përmes LAN, lidhje është 2x RJ4 5 për LAN me 10/100 Mbit / s



Fig2.5 Moduli i komunikimit CP 343-1 Lean

2.1.2 Karakteristikat e SIMATIC S7-300

1. Sistem modular i kontrollit të vogël
2.Diapazon i vlerësuar me performancë të CPU-së
3. Zgjedhje e gjerë e moduleve, dizajn i zgjerueshëm deri në 32 module
4. Busi Backplane i integruar në module
5. Mund të rrjetëizohet me MPI, Profibus ose Ethernet Industrial
6. Lidhja qendrore PG / PC me qasje në të gjitha modulet
7. Pa kufizime në fole
8. Konfigurimi dhe vendosja e parametrave me ndihmën HW Configuration



Fig 2.6 Arkitektura e PLC-së e SIMATIC S7-300

2.1.3 Pozicionimi i moduleve të S7-300 në raft

Në S7 -300 renditja e moduleve behet në këtë mënyrë

1 Furnizimi me energji (Power supply)
2 CPU
3 Moduli i ndërfaqes ose Moduli i Zgjerimit të PLC (Interface module (IM))
4-11 Përdoren modulet e sinjaleve SM I/O , Moduli i komunikimit (Communication processor (CP)), Modulet e funksioneve FM (Function modules (FM)) etj.



Fig 2.7 Pozicionimi i moduleve të S7-300 në raft

2.1.4 CPU S7 – 300 dhe funksionimi i tij

- MRES = Funksioni i rivendosjes së kujtesës
- STOP = Modaliteti i ndalimit, programi nuk ekzekutohet në kete mod
- RUN = Ekzekutimi i programit
- RUNP = Ekzekutimi i programit, hyrja e leximit / shkrimit, treguesi i statusit
- SF = Gabim grupi, CPU i brendshëm ose është defekt në modul
- BATF = Dështimi i baterisë
- DC5V = Tregues i tensionit të brendshëm 5 VDC
- FRCE = FORCA
- RUN = Ndezët kur CPU fillon punën
- STOP = Shfaq një dritë të qëndrueshme në modalitetin Stop
- SF DP = Faji i busit fizik
- BUSF = Nuk ka asnjë konfigurim ose konfigurimi është i pasaktë



Fig 2.8 CPU 314c-2dp

3. MËNYRAT E KOMUNIKIMT TË PLC-ve TË SIMATIC S7-300

3.1 Lidhja e rrjetit të SIMATIC-ut dhe lidhjet e pjeseve të PLC-së

Një fabrike industrial përdore sistemin e rrjetin e komunikimit Fieldbus. Fieldbus është rrejt komunikimi që përdoret në një makineri që i lidhe senzoret actuator (motor) me njëri-tjetrin në një ose më shumë (PC industrial ,PLC). Këto rrjete janë të dizenjuara me specifikime të veçanta që i dallojnë ato nga rrjetet e tjera kompjuterike dhe u mundësojnë atyre të operojnë në mjedise industriale në kushte shumë të pafavorshme.



Fig 3.1 Lidhja e rrjetit të SIMATIC-ut dhe lidhjet e pjeseve të PLC-së

3.2 Pika e shumfishtë e ndërfaqjes – MPI

MPI është zgjidhje me kosto të ulët për komunikim me veglat programuese dhe PC (kompjuterit), sistemit HMI(R) dhe kontrolluesit e tjerë SIMATIC S7/C7/WinAC. Stacionet totale 125 MPI mund të lidhen në transmisionin e shkallës 187.5 kbit/s, p.sh, për shkëmbimin e të dhënave në mes të kontrollerëve të ndryshëm ose funksioneve HMI pa pasur nevojë për ndonjë programim të lartë. Me CPU 317 dhe 318-2 DP, MPI gjithashtu mund të përdoret si PROFIBUS DP dhe lejon konfigurimin e dy linjave DP.

Kablli MPI e lidhë kompjuterin me njësinë qendrore të përpunimit (CPU).

3.3 Profibus

Profibus aktualisht është rrjeti më i optimizuar industrial, pasi siguron transmetim mesatar të të dhënave ndërmjet stacioneve. Parimi i tij i funksionimit bazohet në kalimin e shenjave, d.m.th. të gjitha stacionet marrin dhe dërgojnë informacione në mënyrë ciklike. Kështu, është me diferncë deri më tani rrjeti më i përhapur në përdorim. Profibus DP është i orientuar te komunikimi, në transmetimin ciklik të një sasie të vogël të të dhënave me shpejtësi të mëdha në distanca të gjata ndërmjet automatizimit dhe sistemeve të kontrollit dhe ofron parashikimin për njësi të shpërndara input / outp



Fig 3.2 Një lidhja e rrjetit me profibus-DP

3.4 Profinet

Interface i integruar PROFINET përdoret për programim, komunikim të HMI dhe gjithashtu edhe për komunikim në mes të PLC-.Profinet është një model standart.

PROFINET miraton Industriale Standardet Ethernet për mjedisin e automatizimit që përfshin komunikimn nëpër fabrikë, zyrën në fabrikë dhe komunikimet pajisje me pajisje. PROFINET është të dizajnuara për të trajtuar njëkohësisht TCP / IP standarde dhe transmetimet e kohës. PROFINET përdor teknologjinë PROFIBUS.

Interface PROFINET përmban një konektor RJ45 që siguron 10/100 Mbit/s shpejtesi të transferimit të të dhënave dhe mban deri në 16 lidhje Ethernet me protokollet e mëposhtëm: TCP / IP native, ISO -on-TCP komunikon me S7.



Fig 3.3 Një lidhja e rrjetit me profinet

3.5 Ethernet Industrial

Ethernet Industrial ka shumë avantazhe, duke përfshirë ndërlidhshmërinë në shumë rrjete të tjera, lidhje interneti,transmetim të sigurt pa tel dhe pajisje shumë të lira ndërlidhjeje. Shumë probleme nga e kaluara mund të zgjidhen nga Ethernet, i cili megjithatë është një rrjet i projektuar për informacione në lidhje me rrjetin, duke e bërë atë të papërshtatshëm për kontroll të saktë në kohë reale në aplikacione të tilla si shpejtësia dhe kontrolli i pozicionit në sistemet elektromotorike. Ethernet-i nuk mund ti ofroj industrisë rezultatin deciziv qe i ka ofruar informatikes, por mban avantazhe të mëdha, të cilat janë gjithashtu të dobishme në aplikimet industriale, siç janë qasja e lehtë në makinerit nga ndërfaqet në internet, dërgimi i postës elektronike, prodhimi i informacionit për humbjen e kohës. Dhe adresimin automatik të pajisjeve të ndryshm.



Fig 3.4 Një lidhje e rrjetit e Ethernet Industrial

4. ELEMENTET PËRBËRËSE TË SHIRITIT TRANSPORTUES DHE ROBOTIT SKARA

4.1 Shiriti transmetues dhe roboti scara

- Roboti SCARA është tip i robotit industrial. Shkurtesa “SCARA” nënkupton ’’Selective Compliance Assembly Robot Arm”. Tek ky robot, nyjet janë të lëvizshme përgjatë aksit X dhe Y por përgjatë aksit Z ato janë të palëvizshme. Kjo paraqet një avantazh të përdorimit të ktij tipi të robotit për arsye se gjatë proceseve të montimit p.sh vendosja e shufrës në vrimë rrethore arrihet pa përkuljen e nyjeve të robotit me q’rast rritet saktësia dhe stabiliteti i tërë sisë.

- Veqori tjetër e robotit SCARA është mënyra e lidhjes së nyjeve që i përngjason krahëve të njeriut. Kjo veqori lejon shtrirjen e krahëve të robotit në zona të kufizuara dhe më pas mundëson tërheqjën apo palosjen e krahëve përgjatë rrugës.

- Robotët SCARA janë dukshëm më të shpejtë se robotët që kanë për bazë sistemin Kartezian. Vend i nevojshëm për shtrëngim të ktyre robotëve është mjaft i vogël me q’rast e bën këtë robot mjaft të dobishëm në zvoglimin e hapsirës së nevojshme e cila do të shfrytëzohet nga ky robot.

-Krahu robotik i robotit **SCARA** punon në bazë të ketij parimi:

-Para qdo fillim të punës së procesit me robotin SCARA, duhet qe të iniciojmë vlerat referente apo të kalibrojmë krahun robotik në pikën fillestare (zero).

-Ky kalibrim i krahut robotik në pikën zero bëhet duke vendosur qelesin në pikën zero, pas vendosjës se qelësit në pikën zero dhe me pas shtypjës së tasterit START roboti fillon të shkoj të vëndoset tek pika zero, pavarësisht pozitës aktuale se ku gjndet ky krah robotik.

-Pasi të përfundoj incimi i procesit për kthimin e krahut robotic në pikën zero, roboti automatikisht vije dhe qendron mbi shiritin transportues dhe është i gatshëm për fillimin e procesit të punës.

-Ngasja e pjeseve të krahut robotik bëhët me DC Motor, ndersa feedback për leximin e vlerave të cilat e tregojnë pozitën e krahut robotik bëhet me encoder.

-Encoderi është një lloj senzori i cili varësisht nga konfigurimi i tij na jep numer të cakuar të pulseve për një rrotullim në rastin tonë konkret ne e kemi përdorur nje encoder me 1024 pulse për rrotullim ndersa tek PLC-ja encoderi lidhet me modul të veqantë High Speed Counter 500 MHz.



Fig. 4.1 Pamja e robotit SCARA, PLC S7-300 dhe paisja programuese

4.2 Modelimi i robotit SCARA

Pjesët përbërëse të robotit SCARA janë: bazamenti, mbajtësi i gotave, shufra e pare, shufra e dytë, shufra e tretë, kapësja me veprim pneumatik etj. Komponentet përbërëse të përmendura janë esenciale për realizimin e simulimit . Në vazhdim do të paraqesim detajisht secilën nga pjesët përbërëse të ktij roboti.



Fig. 4.2 Pamja e plotë e Robotit SCARA

4.3 Kinematika inverze e SCARA Robotit

Paraqesim Robotin SCARA me te gjitha parametrat e levizjeve kinematik të tij.



Fig. 4.3 Kinematika inverze e robotit Scara

4.4 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit të parë dhe me komandat e lëvizjes



Fig. 4.4 Roboti Skara aksi i parë.

4.5 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit dytë



Fig. 4.6 Roboti Skara aksi i dytë

4.6 Roboti Skara me pjesët përbërëse të aksit të tretë



Fig. 4.7 Roboti Skara aksi i tret

4.7 Shiriti transmetues

Shiriti i transmetimit përdoret për bartjen ose transportimin e materialeve të ndryshme si psh (rërë,xehe,qymyr) ose materiale te tjera te çfarëdoshme.

Shiriti përbëhet nga një ose më shumë shtresa të materialit. Shumica e shiritave në trajtimin e materialeve të përgjithshme përbëhen nga dy shtresa:

"Skeleti" që ndodhet në pjesën e brendshme të shiritit dhe që siguron forcën dhe formën lineare, ndërsa "mbulesa" është emri i shtresës së sipërme.

4.8 Shiritit transportues me elementet përbërëse



Fig. 4.7 Shiriti transportues.

4.1.1 Komandimi i robotit SCARA dhe shiritit

-Me termin "komandim" nenkuptohet një proces në një sistem në të cilin një apo më shumë madhësi (hyrëse), ndikojnë në madhësitë dalëse të një procesi teknik.

-Sikurse të gjitha sistemet që bejnë perpunimin e informatave edhe komandimet punojnë sipas principit:

H - Rafshi hyrës (input)

P - Reafshi përpunues

D - Rrafshi dalës (output)

4.1.2 Tipet e komandimit

Sistemet komanduese mund të hasen në secilen pjesë të paisjeve/makinave. Ato mund të jenë: mekanike, pneumatike, hidraulike, elektrike dhe elektronike. Shpesh aplikohen teknologji të kombinuara të këtyre komandimeve. Përgjithësisht dallojmë dy forma komandimi: Komandimi i programueshëm lidhës (KPL) dhe komandimi logjik i programueshëm (PLC).

Ne detyren tone për komandim të robotit SCARA kemi perdorur komandimin përmes PLC-së.



4.1.3.Komandimi i realizuar përmes lidhjeve mekanike të fiksuara:

Programi është realizuar përmes një lidhjeje të ngurtë p.sh. përmes një pikësi. Ndryshimet e programit nuk mund të bëhen pa përdorimin e veglave të punës.

4.1.4.Komandimi i realizuar përmes lidhjeve mekanike të ndashme:

Programi zakonisht mund të ndërrohet pa përdorimin e veglave të punës dhe pa shpenzime të mëdha p.sh. përmes terminalit ndarës.

I programueshëm në RAM:

Programi i cili gjendet në pjesën interne te memories mund të ndërrohet pjesërisht apo plotësisht pa pasur nevojë që të intervenohet në mënyrë mekanike.

I programueshëm në ROM:

Programi gjendet në një medium ekteronik ekstern p.sh. FEPROM dhe për t'u ndryshuar ai duhet domosdoshmërish të largohet nga Hardueri dhe të bëhet këmbimi i tij me një program ekstern të ri apo të ndryshuar.

4.1.5 Tipet e sinjaleve në teknikën e kontrollimit

Para se të merremi me PLC-të, duhet së pari të i sqarojmë llojet e sinjaleve në teknikën komanduese për arsye se kjo ka rëndësi të madhe për kuptimin e mëtutjeshëm të punës. Sinjalet elektrike që paraqiten në hyrjet dhe daljet përgjithësisht mund t'i klasifikojmë në dy grupe:



Fig.4.8 Sinjali binar dhe analog

4.1.6. Sijalet binare

Sinjalet binare mund të kenë vetëm dy gjendje:

Gjendja e sinjalit „1“ Ka tension p.sh. Ndërprerësi është i kyçur

Gjendja e sinjalit „0“ Nuk ka tension p.sh. Ndërprerësi është i shkyçur

Në teknikën komanduese shpesh përdoret tensioni prej 24V i cili quhet „Tensioni komandues“. Niveli i tensionit prej + 24V në një terminal hyrës e ka kuptimin për këtë hyrje gjendja e sinjalit „1“. Në anën tjetër 0V nënkupton gjendjen e sinjalit „0“. Përveç kësaj për gjendjen e sinjalit është me rëndësi edhe një radhitje logjike. Duhet pasur parasysh se tek një

dhënës a kemi të bëjmë me një „Hapës“ apo me një „Mbyllës“. Një hapës në gjendje të qetë bart sinjalin „1“ kurse kur ai është aktiv bart sinjalin „0“. Një mbyllës në gjendje të qetë bartë sinjalin „0“ kurse kur ai është aktiv bart sinjalin „1“.

4.1.7 Vlerat binare

Një sinjal binar mund t'i ketë vetëm dy vlera të sinjalit (gjendje të sinjalit) „0“ dhe „1“. Një sinjal i tillë binar quhet edhe vlera binare dhe në terminologjinë teknike merr emërtimin „Bit“. Disa sinjale binare të përmbledhura në një forme të veçantë (Kode) japin një sinjal digjital. Derisa një sinjal binar mundëson aplikimin e një madhësie me dy vlera (p.sh. të hapet dera / të mbyllet dera), bashkimi i sinjaleve të tilla bën të mundur shndërrimin e numrave apo shifrave në informata digjitale. Përdorimi i n-vlerave binare lejon paraqitjen e 2n kombinacioneve të ndryshme. Kështu kjo mundëson që p.sh. me dy vlera binare 2x2 pra të i jap katër lloj përmbajtje të ndryshme të informatave.

0 0	*Informata 1*	*(p.sh. të dy ndërprerësit qëndrojnë të hapur)*
0 1	*Informata 2*	*(Ndërprerësi 1 hapet / Ndërprerësi 2 mbyllet)*
1 0	*Informata 3*	*(Ndërprerësi 1 mbyllet / Ndërprerësi 2 hapet)*
1 1	*Informata 4*	*(Të dy ndërprerësit mbyllen)*

4.1.8 Sinjalet analoge

Për ndryshim nga një sinjal binar i cili mund të marr vetëm dy vlera të ndryshme, „Tensioni rrjedh + 24V” dhe „Tensioni nuk rrjedh 0V”, sinjalet analoge mund të marrin në një fushë të caktuar sa të dëshirojmë vlera të ndryshme. Një shembull tipik për një dhënës (emetues) analog e kemi në rastin e potenciometrit (me rezistencë të ndryshueshme). Varësisht nga pozita e ndërprerësit rrotullues mund të përdoret një vlerë maksimale e rezistencës.

Shembuj të madhësive analoge të aplikuara në teknikën komanduese :

Temperatura -50 ... + 150°C

Rrjedhja 0 ... 200 l/min

Numri i rrotullimeve 500 ... 1500 Rr/min etj. Këto madhësi me ndihmën e një transformatori shndërrohen në tension elektrik, rryma elektrike apo rezistenca. Nëse p.sh. duhet të bëhet reduktimi i numrit të rrotullimeve prej 500.....1500 Rr/min kjo mund të arrihet duke e bërë ndryshimin përmes një transformatori për vlera te tensionit 0.... + 10V.

5. SIMBOLET DHE VARIABLAT PËR PROGRAMIMIN E PLC-së

5.1 URDHËRAT E PËRDORURA PËR PROGRAMIMIN E SCARA ROBOTIT DHE SHIRITIT TRANSMETURS

Secili udhëzues logjik përshkruhet në këtë temë me një operacion specifik. Nëse kombinojmë këto udhëzime në program, mund të realizojmë një shumëllojshmëri detyrash të automatizimit. Në këtë kapitull shqyrtohen shembuj të aplikimit praktik të shënuar më poshtë: Kontrollimi i shiritit transportues dhe i scara robotit duke përdorur udhëzuesin e bitit logjik. Detektimin e drejtimit të lëvizjeve në shiritin transportues dhe Scara Roboti duke përdorur udhëzusin e bitit logjik.Gjenerimi i pulseve të orës duke përdorur udhëzimet kohore.Mbajtja e rrugës, drejtimit nga depoja duke përdorur udhëzimet e numërusit dhe krahasuesit. Zgjedhja e një problemi duke përdorur udhëzimet matematikore.

5.2 Udhëzimet e përdorura

Memorja	**Elementet e programit**	**Pershkrimi i katalogut**
WAND_W	Udhëzimi i fjalëve logjike	(fjalë) dhe fjalë
WOR_W	Udhëzimi i fjalëve logjike	(fjalë) ose fjalë
---(CD)	Numërues	Unaza numëruse e poshtme
---(CU)	Numërues	Unaza numëruse e epërme
---(R)	Udhëzimet e bitit logjik	Rivendosje e unazës
---(S)	Udhëzimet e bitit logjik	Vendosje e unazës
---(P)	Udhëzimet e bitit logjik	RLO kufiri pozitiv
ADD_I	Udhëzimet e pikes qarkulluse	Vendos kufirin (integrimin)
DIV_I	Udhëzimet e pikes qarkulluse	Ndaje kufirin (integrimin)
MUL_I	Udhëzimet e pikes qarkulluse	Kufiri i shumëllojshëm
CMP <=|	Krahason	Krahason kufijt (integrimin)
—| |—	Udhëzimet e bitit logjik	Kontaktet e hapura normale
—| / |—	Udhëzimet e bitit logjik	Kontaktet e mbyllura normale
—( )	Udhëzimet e bitit logjik	Unaza e prodhimit
---(JMPN)	Kalimi	Kalo-nëse-jo

---(RET)	Kontrolimi i programit	Rikthim
MOVE	Lëviz	Cakto vlerën e lëvizjes
--- (SE)	Kohor	Unaza e zhgjeruar kohore

Urdhërat e Bit Logic punojnë me dy shifra, 1 dhe 0. Këto dy shifra e formojnë bazën e një sistemi numerik të quajtur sistem binar. Të dy shifrat 1 dhe 0 quhen shifra binar apo bita. Në botën e kontakteve dhe mbështjelljeve, një ‘’1’’ tregon që një gjendje është aktivizuar apo ka energji, dhe një ‘’0’’ tregon se nuk ka aktivizim ose themi nuk ka energji.

Udhëzimet ‘’Bit Logic’’ tregojnë gjendjet e sinjalit ‘’1’’ dhe ‘’0’’, të kombinuara sipas logjikës së Boolean. Këto kombinime që prodhojnë rezultat prej gjendjes ‘’1’’ ose ‘’0’’ quhen rezultat i operacionit të logjikës (RLO).



Fig 5.1 operacioni i logjkës RLO

Operacionet logjike që janë shkaktuar nga udhëzimet Bit Logic kryejnë një sërë funksionesh Ekzistojnë shumë udhëzime Bit Logic për të kryer operacionet e mëposhtme:

---| |--- Kontakti normalisht i hapur (Address)
---| / |--- Kontakti normalisht i mbyllur
---(SAVE) Ruajtja e RLO në kujtesën BR
XOR Bit ekzkluziv OR
---( ) Spiralja dalëse ose (prodhuese)
---(#)--- Mesvijë prodhuese
---|NOT|--- Energji rrjedhëse anasjelltas.

Udhëzimet e mëposhtme reagojnë ndaj një RLO nga gjendja ‘’1’’

---(S) Spirale e vendosur (Set Coil)
---(R) Spirale e rivendosur (Reset Coil)
SR Vendos Rivendos ‘’Flip Flop’’ (Set Reset)
RS Rivendos Vendos ‘’Flip Flop’’ (Reset Set).

Udhëzimet tjera reagojnë në tranzicionin pozitiv ose negativ, për të kryer funksionet e mëposhtme:

---(N)--- Zbulimi negativ RLO
---(P)--- Zulimi pozitiv RLO
NEG Buzë-zbulimi apo Adresimi ngativ
POS Buzë-zbulimi apo Adresimi pozitiv
Immediate Read (Lexim i menjëhershëm)
Immediate Write (Shkrim i menjëhershëm).

5.3 Simbolet e operacioneve binare

Për të zgjedhurë problemin ton e Scara Robotit dhe shiritit transmetues, duet ti dim sibolet e PLC -së dhe si futen ato në simatic menager s7

5.1.2 Kontakti NO (---| |---)

Këto janë kontakte te hapura (Normal i Hapurë) . Në qoftë se ato mbyllen atehere kemi sinjal ne dalje, nese kontakti është i hapur nuke kemi sinjal në dalje



Informata dalëse ekziston nëse plotësohet kushti
Nëse në hyrje I 0.0 dhe I 0.1 është "1" , kemi sinjalnë dalje
Nëse në hyrje I 0.2 është "1" , kemi sinjalnë dalje

5.1.3 Kontakti NC ---| / |---

Këto janë kontakte te Mbyllura (Normal i Mbyllur) në qoftë është I hapur se sinjali është 1 nëse është I mbyllur sinjali është 0, e kunderta me NO



5.1.4 Operacioni logjik binar DHE OSE (AND dhe OR)

Operacioni AND eshte i lidhur ne një qark në seri, y=A*B

Me (AND) mund të kontrollojmë sinjalin e dy ose më shumë hyrjeve specifike. Nëse gjendja e sinjalit është 1 kushti është i mjaftueshëm dhe rezultati i daljes është i barabartë me 1 (në këtë rast njësia hyrëse është e barabartë me njësinë dalëse). Nëse sinjali i hyrjes është 0 (Zero) kushti është i pa mjaftueshëm, dalja është 0. Nëse blloku AND është blloku i parë në opercion logjik, ai ruan rezultatin nga R20 bit. Qdo bllok AND i cili nuk është bllok i parë, kombinon rezultatin e sinjaleve hyrëse me vlerën e ruajtur nga biti RLO. Këto vlera kombinohen në bazë të tabelës së bllokut & (AND).

Ndersa ne operacioni OSE (OR) portat jane te lidhur paralel për të dhënë daljen y=A+B

Me operacionin logjik OSE (OR) mund të kontrollojmë sinjalin hyrës të dy ose më shumë adresa hyrëse. Nëse gjendja e njërit nga sinjalet hyrëse është 1 kushti plotësohet, operacioni logjik OSE prodhon rezultatin në dalje 1.

Në fig kemi operacionet binare të cilet shkruhen në programin Simatic Menager S7



AND

I 0.0	I 0.1	Q 8.0 / Q8.1
0	0	0
0	1	0
1	0	0
1	1	1

OR

I 0.2	I 0.3	Q 8.2
0	0	0
0	1	1
1	0	1
1	1	1

Fig 5.2 Operacioni logjik binar DHE OSE (AND dhe OR) Programi i shkruar në Simatic Menager S7

5.1.5 Operacioni logjik binar NAND dhe NOR

Sigurisht ne kemi dhe rregullin ku NOT lidhet me AND. Kjo është forma e logjikës e njohur si porta NAND. NOT lidhet me OR e njohur si porta NOR Simbolet logjike tregohen në figurën e më poshtme.

Punëtorët e zakonshëm, inxhinierët elektrikë dhe ekspertët në fabrika mund të marrin logjikë të sofistikuar duke përdorur shpejtësinë e zakonshme, si dhe lidhjet në seri dhe paralele me PLC-në. Në shumë raste logjika e përditshme punon me qartësi për njerëzit. Ata duhet të dinë si veprojnë portat logjike, por fakti është që shumë PLC-it kanë lidhje të thjeshta në seri dhe paralele.

Në fig kemi operacionet binare të cilet shkruhen në programin Simatic Menager S7



Fig 5.3 Operacioni logjik binar (NAND dhe NOR) Programi i shkruar në Simatic Menager S7

5.1.6 Operacione logjike binare: (XOR)

Rregulli është i vlefshëm për funksionimin logjik të dy adresave XOR: dalja (Q8.0) ka gjendjen e sinjalit "1", kur vetëm nga të dy kushtet janë përmbushur.si në table



XOR

I 0.4	I 0.5	Q 8.0
0	0	0
0	1	1
1	0	1
1	1	0

Fig 5.4 Operacioni XOR i shkruar në programin Simatic Menager S7, dhe tabela logjike

5.3 Operacionet Logjik

5.3.1 Operacionet Logjik Starto dhe Ristarto Prodhimin (Set, Reset)

Starto (SET). Nëse RLO = "1", adresa e specifikuar është vendosur të sinjalizojë gjendjen "1" dhe mbetet e vendosur deri në një udhëzim tjetër për ta rivendosur adresën.

Ristarto (Reset). Nëse RLO = "1", adresa e specifikuar rivendoset për të sinjalizuar gjendjen "0" dhe mbetet në këtë derisa një udhëzim tjetër të vendosë përsëri adresën. Në fig kemi operacionet logjik të cilet shkruhen në programin Simatic Menager S7



Fig 5.5 Operacionit Logjik Starto dhe Ristarto i shkruar në programin Simatic Menager S7

5.3.2 Ristarto_Starto Flip Flop (rivendos_vendos) dhe RS Reset_set Flip Flop

Udhëzuesi Ristarto_Starto Flip Flop ekzekuton startimin (S) ose ristartimin (R) vetëm kur RLO është 1. Një RLO me vlerë 0 nuk ka efekt në këtë udhëzues, ky udhëzues ristartohet kur gjendja e sinjalit në hyrjen R është 1 dhe në hyrjen S është 0. Nëse hyrja R është 0 dhe hyrja S është 1 flip flopi startohet. Nëse të dy hyrjet e RLO-së R dhe S janë 1, flip flopi startohet. Ky udhëzues dirigjohet nga Master Kontroll Rele MRC.



Fig 5.6 Programi I shkruar në Simatic Menager S7

5.3.4 Vija e mesme dalëse (#) (Midline Output)

Ky artikull ka të bëjë me përdorimin e udhëzimeve të linjës mesatare në siemens PLC. Shumë herë, në programimin industrial PLC duhet të përdorim të njëjtën gjendje shkalle me input shtesë. Tani, për të shkruar të njëjtën logjikë, përsëri dhe përsëri, bëheni të lodhshme dhe konsumoni më shumë kohë. Në programin siemens PLC, dhe menaxherin e Simatic lejojnë përdorimin e udhëzimeve të linjës së mesme (#) për të zëvendësuar tërë atë shkallë me këtë udhëzim të linjës së mesme.

Pra, duke përdorur këtë udhëzim ju mund të kurseni shumë kohë dhe të zvogëloni kompleksitetin e programimit.

Duhet të shtojmë udhëzimet e linjës mesatare në fund të rrjetit. Pra, thjesht kopjon të gjitha të dhënat para saj.

Ne duhet të përdorim të njëjtën adresë në rrjetin e dytë. Ndërsa aktivizojmë të gjitha udhëzimet e linjës së mesme hyrëse kopjojnë të gjitha të dhënat. Në rrjetin e dytë, M5.7 do të qëndrojë energjik. E cila zvogëlon kohën dhe kompleksitetin e logjikës, e bën atë të thjeshtë

Në hyrje sinjali I1.0 dhe dhe I 1.1 është 1 pra RLO=1 atë here në momorien bit M5.7 kemi sinjal dalës (output)



Fig 5.7 Vija e mesme dalëse (#) si shkruhet në Programin Simatic Menager S7

5.3.5 Operacionit Logjik NOT

Nëse sinjali I Hyrjes I0.0 dhe I 0.1 është "1" pra RLO =1, nëse vendosim operacionin Logjik NOT si në fig, montimi nuke mundë të kryhet "0" në Q8.0

Nëse sinjali I Hyrjes I0.0 dhe I 0.1 është "0" pra RLO =0, nëse vendosim operacionin Logjik NOT si në fig montimi mundë të kryhet "1" në Q8.0



Fig 5.8 Operacioni NOT si shkruhet në Programin Simatic Menager S7

5.3.6 Detektimi kufitar i RLO-së, Pozitiv (P) dhe Negativ (N)

Detektimi kufitar i RLO-së. Është kurë rezultati i një ndyshimi logjik operacional ndryshon nga Sinjalet binare "0" tek "1" ose prej "1"tek "0"

Pozitiv (P): (RLO positive) detekton një ndryshim në sinjalin e adreses (M1.0) prej "0" te "1" dhe e shfaqë atë sinjal në RLO=1, që është në punë (M8.0) për një cikël .

Për të mundësuar që sistemi të detektoj ndryshimin kufitar RLO duhet të ruhet në FP memorie bit (sikurse është M1.0)

Pozitiv (N): (RLO Negativ) detekton një ndryshim në sinjalin e adreses (M1.1) prej "1" te "0" dhe e shfaqë atë sinjal në RLO=1, që është në punë (M8.1) për një cikël .

Për të mundësuar që sistemi të detektoj ndryshimin kufitar RLO duhet të ruhet në FN memorie bit (sikurse është M1.1).



Fig 5.9 Detektimi kufitar i RLO-së, Pozitiv (P) dhe Negativ (N) si shkruhet në Programin Simatic Menager S7

5.3.7 Krahasimi i dy vlerave

Udhëzuesi i krahasimit të dy vlerave krahason dy vlera nga baza 32 bit me pikën qarkulluese të numrave. Ky udhëzues krahason hyrjet IN1 dhe IN2 bazuar në llojin e krahasuesit, për secilin rast konkret CMP == D, CMP > D, CMP >= D, CMP < > D, CMP < D,dhe CMP <= D.

Nëse rezultati i krahasimit është "i vërtetë", atëherë RLO -ja e operacionit është "1", përndryshe është "0".

Vlerat në hyrjet IN1 dhe IN2 krahasohen për konformitetin me gjendjen e specifikuar:

I Krahasoni numrat e plotë (në bazë të numrit 16 bit)
D Krahasoni numra e plotë (në bazë të numrit 32 bit)
R Krahasoni numrat real (në bazë të numrit real 32 bit)



Fig 5.1.1 Krahasimi i dy vlerave si shkruhet në Programin Simatic Menager S7

5.3.8. Funksionet bazike matematikore

Programi i S7-300 mbështet në një mori funksionesh matematikore. Të gjitha udhëzimet bazike matematikore kanë të njëjtin format.



Fig 5.1.2 Funksionet bazike matematikore Programi I shkruar në Simatic Menager S7

IN1 dhe IN2 janë adresat në të cilen hynë Vlerat, në IN1 lexohet adresa e parë dhe ndërsa në IN2 adresa e dyta ndersa në OUT janë Rezultati e operacionit matematikor dhe ruhet në adresën e dalje OUT.

Mbledhja:

ADD_I Mbledhja numër të plotë (Integer)

ADD_DI Mbledhja numër të plotë të dyfishtë (dubli integer)

ADD_R Mbledhja një numër real

Zbritja:

SUB_I Zbritja numrin e plotë

SUB_DI Zbritja numrin e plotë të dyfishtë

SUB_R Zbritja numrin real

Shumëzimi:

MUL_I Shumëzimi i numrit të plotë

MUL_DI Shumëzoni numër të plotë të dyfishtë

MUL_R Shumëzoni numrin real

Pjestimi:

DIV_I Pjestimi i numrin e plotë

DIV_DI Pjestimii i numër të plotë të dyfishtë

DIV_R Pjestimi i numrin real

5.3.9 Lëvizja (Move): Transferimi i vlerave



Me udhëzuesin për transferimin e vlerave mund të transferojmë vlerat specifike në variabla. Vlera secifike e hyrjes IN kopjohet në adresën specifike në daljen OUT. ENO ka gjendjen e sinjalit të njejtë sikurse EN. Me kutinë zhvendosëse udhëzuesi i transferimit të vlerave mund të kopjojë të gjitha të dhënat elementare me 8, 16 ose 32 bitëshe.

Mund të caktojmë llojin e të dhënave sikurse në grupe ose struktura të cilat duhet të kopjohen në sistemin e funksionit SFC 20 “BLKMOV”. Ky udhëzues dirigjohet nga Master Kontroll Rele MRC.

